



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 47

2003

Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9059 datë 8.5.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për reduktimin e pashtetësisë”.....	1785
Ligj nr.9060 datë 8.5.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.....	1794
Ligj nr.9061 datë 8.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8097,datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8500, datë 10.6.2000.....	1799
Ligj nr.9063 datë 8.5.2003	Për statusin e trashëgimtarëve të ish-Familjes Mbretërore	1802
Ligj nr.9064 datë 8.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996, nr.8112, datë 23.3.1996 dhe nr.8767, datë 5.4.2001.....	1803

Ligj nr.9065 datë 8.5.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", ndryshuar me ligjin nr.8935, datë 12.9.2002.....	1805
Vendim i Kuvendit nr.75,datë 24.4.2003	Për miratimin e raportit vjetor 2002 të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).....	1807
Urdhër i MBU nr.17/1, datë 21.5.2003	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Shëngjin).....	1807
Urdhër i MBU nr.17/2,datë 21.5.2003	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP Liqeni i Shkodrës).....	1808

L I G J
Nr.9059, datë 8.5.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
“KONVENTËN PËR REDUKTIMIN E PASHTETËSISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për reduktimin e pashtetësisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3826, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTA
MBI REDUKTIMIN E PASHTETËSISË

Bërë në New York më 30 gusht 1961

Hyrja në fuqi: 13 dhjetor 1975 në përputhje me nenin 18

Teksti: Dokumentet e OKB-së A/CONF.9/15, 1961

Shtetet Kontraktuese:

duke vepruar në përputhje me rezolutën 896 (IX), adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 4 dhjetor të vitit 1954;

duke e konsideruar atë të dëshirueshme për të reduktuar pashtetësinë me marrëveshje ndërkombëtare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Një Shtet Kontraktues duhet t'i japë shtetësinë e tij një personi të lindur në territorin e atij shteti, i cili ndryshe mund të jetë pa shtetësi. Kjo shtetësi i jepet:

a) me lindjen, nga veprimi i ligjit ose

b) në bazë të një aplikimi të paraqitur tek autoritetet përkatëse, nga ose në emër të një personi të interesuar, në mënyrën e parashikuar nga ligji i brendshëm. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, asnjë aplikim i tillë nuk mund të kundërshtohet.

Një Shtet Kontraktues, i cili merr masa për dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me nënparagrafin (b) të këtij paragrafi mundet gjithashtu të sigurojë dhënien e shtetësisë së tij në bazë të ligjit në një moshë të tillë dhe të kushteve të tilla, siç mund të jetë parashikuar nga e drejta e brendshme.

2. Një Shtet Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me nënparagrafin (b) të paragrafit 1 të këtij neni sipas një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

a) që aplikimi të jetë paraqitur gjatë një periudhe, të përcaktuar nga Shteti Kontraktues, duke filluar jo më vonë se mosha tetëmbëdhjetë vjeçe dhe duke mbaruar jo më herët se mosha njëzet e një

vjeçe, kështu gjithsesi, personi i interesuar do të lejohet së paku një vit, gjatë të cilit ai mund të bëjë vetë aplikimin pa pasur nevojë të marrë autorizimin ligjor për të vepruar kështu;

b) që personi i interesuar të ketë banuar vazhdimisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë të tillë siç mund të përcaktohet nga ai shtet, pa kaluar pesë vjet menjëherë para paraqitjes së aplikimit dhe as dhjetë vjet në tërësi;

c) që personi i interesuar të mos ketë qenë dënuar për shkelje kundër sigurisë kombëtare dhe as të ketë qenë dënuar me burgim për një periudhë pesëvjeçare ose më shumë për një vepër penale;

d) që personi i interesuar të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1(b) dhe 2 të këtij neni, një fëmijë i lindur nga martesa në territorin e një Shteti Kontraktues, nëna e të cilit ka shtetësinë e atij shteti, përfiton në lindje atë shtetësi, nëse prindërshe mund të jetë pa shtetësi.

4. Një Shtet Kontraktues i jep shtetësinë e tij një personi i cili prindërshe mund të jetë pa shtetësi dhe i cili nuk është në gjendje të përfitojë shtetësinë e Shtetit Kontraktues në territorin e të cilit ai ka lindur, sepse ai ka kaluar moshën për të paraqitur aplikimin e tij ose nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara të banimit, nëse shtetësia e njërit prej prindërve të tij në kohën e lindjes së personit ishte ajo e Shtetit Kontraktues të përmendur më lart. Nëse prindërit e tij nuk mbanin të njëjtën shtetësi në kohën e lindjes së tij, çështja, nëse shtetësia e personit në fjalë ndjek atë të babait ose atë të nënës, vendoset nga e drejta e brendshme e këtij Shteti Kontraktues. Nëse kërkohet aplikimi për një shtetësi të tillë, aplikimi bëhet tek autoritetet përkatëse ose në emër të kërkuesit në mënyrën e përshkruar nga e drejta e brendshme. Në bazë të dispozitave të paragrafit 5 të këtij neni, një aplikim i tillë nuk refuzohet.

5. Shteti Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

a) që aplikimi të jetë paraqitur përpara se kërkuesi të arrijë në moshë, e cila është më pak se njëzet e tre vjeçe, të caktuar nga Shteti Kontraktues;

b) që personi i interesuar të ketë banuar zakonisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë të tillë që i paraprin menjëherë paraqitjes së aplikimit, duke mos kaluar tre vjet, siç mund të jetë caktuar nga ai shtet;

c) që personi në fjalë të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

Neni 2

Një fëmijë i braktisur, i gjetur në territorin e një Shteti Kontraktues duhet, në mungesë të provave në të kundërt, të konsiderohet se ka lindur brenda atij territori të prindërve që mbajnë shtetësinë e atij shteti.

Neni 3

Për qëllimin e përcaktimit të detyrimeve të Shteteve Kontraktuese sipas kësaj Konvente, lindja në një anije ose në një avion gjykohet se ka ndodhur në territorin e atij Shteti të flamurit të anijes ose në territorin e atij shteti ku është regjistruar avioni, siç mund të jetë rasti.

Neni 4

1. Një Shtet Kontraktues i jep shtetësinë e tij një personi, që nuk ka lindur në territorin e një Shteti Kontraktues i cili ndryshe do të jetë pa shtetësi, nëse shtetësia e njërit prej prindërve të tij në kohën e lindjes së personit ishte e atij shteti. Nëse prindërit e tij nuk kishin të njëjtën shtetësi në kohën e lindjes së tij, çështja, nëse shtetësia e personit të interesuar duhet të ndjekë atë të babait ose atë të nënës, duhet të vendoset nga e drejta e brendshme e këtij Shteti Kontraktues. Shtetësia e dhënë në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi jepet:

a) në lindje, nga veprimi i ligjit ose

b) në bazë të një aplikimi të paraqitur tek autoritetet përkatëse, nga ose në emër të vetë personit të interesuar, në mënyrën e parashikuar nga e drejta e brendshme. Bazuar në dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, asnjë aplikim nuk refuzohet.

2. Një Shtet Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë së tij në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

a) që aplikimi të jetë paraqitur përpara se aplikanti të ketë arritur një moshë, që është jo më pak se 23 vjeç, të caktuar nga Shteti Kontraktues;

b) që personi i interesuar të ketë banuar zakonisht në territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhë që të mos i kalojë tre vjet që i paraprin menjëherë paraqitjes së aplikimit, siç mund të caktohet nga ai shtet;

c) që personi i interesuar të mos ketë qenë dënuar për një veprë penale kundër sigurisë kombëtare;

d) që personi i interesuar të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi.

Neni 5

1. Nëse ligji i një Shteti Kontraktues kërkon humbjen e shtetësisë si pasojë e ndonjë ndryshimi në statusin personal të një personi të tillë, si martesë, mbarimi i martesës, legjitimimi, njohja ose adaptimi, një humbje e tillë kushtëzohet nga zotërimi ose fitimi i një shtetësie tjetër.

2. Nëse, sipas ligjit të një Shteti Kontraktues, një fëmijë i lindur jashtë martese humb shtetësinë e atij shteti si pasojë e njohjes së atësisë, atij i jepet një mundësi për ta rifituar atë shtetësi me anë të aplikimit me shkrim drejtuar autoriteteve përkatëse dhe kushtet që rregullojnë këtë aplikim nuk duhet të jenë më rigorozë, sesa ato të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 1 të kësaj Konvente.

Neni 6

Nëse ligji i një Shteti Kontraktues parashikon humbjen e shtetësisë së tij nga bashkëshorti ose fëmijët e një personi, për shkak se ai person e ka humbur ose është privuar nga ajo shtetësi, një humbje e tillë kushtëzohet nga zotërimi ose fitimi i një shtetësie tjetër.

Neni 7

1.a) Nëse ligji i një Shteti Kontraktues e lejon heqjen dorë nga shtetësia, një veprim i tillë nuk rezulton në humbjen e shtetësisë, nëse personi i interesuar nuk zotëron ose fiton një shtetësi tjetër.

b) Dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi nuk zbatohen atje ku zbatimi i tyre mund të mospërputhet me parimet e parashikuara në nenet 13 dhe 14 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut e miratuar më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

2. Një shtetas i një Shteti Kontraktues, i cili kërkon natyralizimin në një vend të huaj, nuk humbet shtetësinë e tij po të mos ketë fituar ose po të mos i jetë dhënë siguria e fitimit të shtetësisë së atij vendi të huaj.

3. Bazuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, një shtetas i një Shteti Kontraktues nuk do ta humbë shtetësinë e tij, për t'u bërë pa shtetësi, për arsye të largimit, qëndrimit jashtë vendit, mosregjistrimit ose për çdo arsye të ngjashme.

4. Një person i natyralizuar mund ta humbë shtetësinë e tij për shkak të banimit jashtë vendit për një periudhë, jo më pak se shtatë vjet rresht, të përcaktuar nga ligji i Shtetit Kontraktues, nëse ai nuk u deklaron autoriteteve përkatëse qëllimin e tij për të rifituar shtetësinë e tij.

5. Në rastin e një shtetasi të një Shteti Kontraktues, të lindur jashtë territorit të tij, ligji i atij shteti mund të kushtëzojë ruajtjen e shtetësisë së tij, pas skadimit të një viti nga koha kur është bërë madhor me vendbanimin në atë kohë në territorin e shtetit ose regjistrimit tek autoritetet përkatëse.

6. Përveç rrethanave të përmendura në këtë nen, një person nuk humbet shtetësinë e një Shteti Kontraktues, nëse një humbje e tillë do ta bëjë atë pa shtetësi, pavarësisht se një humbje e tillë nuk ndalohet shprehimisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Konvente.

Neni 8

1. Një Shtet Kontraktues nuk privon një person nga shtetësia e tij, nëse një privim i tillë do ta bëjë atë pa shtetësi.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një person mund të privohet nga shtetësia e një Shteti Kontraktues:

a) në rrethanat në të cilat, sipas paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 7, është e lejueshme që personi ta humbasë shtetësinë e tij;

b) atje ku shtetësia është fituar nga keqpërfaqësimi ose mashtrimi.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një Shtet Kontraktues mund të fitojë të drejtën për të privuar një person nga shtetësia e tij, nëse në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit specifikon ndalimin e një të drejte të tillë në bazë të një ose më shumë prej arsyeve të mëposhtme, arsye të cilat ekzistojnë në ligjin e tij të brendshëm në atë kohë:

a) që në mospërputhje me detyrën e tij të besnikërisë ndaj Shtetit Kontraktues, personi:

i) me mospërfillje ndaj një ndalimi të shprehur nga Shteti Kontraktues, ka dhënë ose vazhdon të japë shërbime ndaj, ose ka marrë apo vazhdon të marrë rrogë nga një shtet tjetër;

ii) ka kryer një sjellje në një mënyrë seriozisht të dëmshme ndaj interesave kryesore të shtetit;

b) që personi ka bërë një betim ose një deklaratë formale për besnikëri ndaj një shteti tjetër ose ka dhënë dëshmi të qartë të vendosmërisë së tij për të refuzuar njohjen e besnikërisë së tij ndaj Shtetit Kontraktues.

4. Një Shtet Kontraktues nuk duhet të ushtrojë funksionin e privimit të lejuar nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, përveçse në përputhje me ligjin, i cili do të sigurojë për personin në fjalë të drejtën për një dëgjim të drejtë nga një gjykatë ose një trup tjetër i pavarur.

Neni 9

Një Shtet Kontraktues nuk mund të privojë një person ose një grup personash prej shtetësisë së tyre për arsye raciale, etnike, fetare ose politike.

Neni 10

1. Çdo traktat ndërmjet Shteteve Kontraktuese që parashikon transferimin e territorit përfshin dispozita të hartuara për të siguruar që asnjë person nuk do të bëhet pa shtetësi si rezultat i transferimit. Një Shtet Kontraktues bën përpjekjet e tij më të mira për të siguruar që çdo traktat i tillë, i bërë prej tij me një shtet, i cili nuk është Palë e kësaj Konvente të përfshijë dispozita të tilla.

2. Në mungesë të dispozitave të tilla një Shtet Kontraktues, të cilit i është transferuar territori ose i cili përndryshe fiton territor do t'ua akordojë shtetësinë e tij personave të tillë të cilët mund të bëhen pa shtetësi si rezultat i transferimit ose i fitimit.

Neni 11

Shtetet Kontraktuese nxisin në kuadrin e Kombeve të Bashkuara, sa më shpejt që mund të jetë e mundur, pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit, krijimin e një organizmi ku një person që pretendon të përfitojë nga kjo Konventë mund të aplikojë për shqyrtimin e pretendimit të tij dhe për ndihmë për t'ua paraqitur atë autoriteteve përkatëse.

Neni 12

1. Në lidhje me një Shtet Kontraktues, i cili nuk i jep, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 1 ose nenit 4 të kësaj Konvente, shtetësinë e tij në lindje me ligj, dispozitat e paragrafit 1 të nenit 1 ose 4, sipas rastit, zbatohen ndaj personave të lindur para, si dhe personave të lindur pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Dispozitat e paragrafit 4 të nenit 1 të kësaj Konvente zbatohen ndaj personave të lindur para, si edhe personave të lindur pas hyrjes në fuqi të saj.

3. Dispozitat e nenit 2 të kësaj Konvente zbatohen vetëm ndaj fëmijëve të braktisur, të gjetur në territorin e një Shteti Kontraktues pas hyrjes në fuqi të Konventës.

Neni 13

Kjo Konventë nuk interpretohet se ndikon ndaj ndonjë dispozite më ndihmuese ndaj reduktimit të pashtetësisë, e cila mund të përfshihet në të drejtën e brendshme të çdo Shteti

Kontraktues, që është ose do të jetë në fuqi, ose që mund të përfshihet në çdo konventë tjetër, traktat ose marrëveshje që është ose do të jetë në fuqi midis dy ose më shumë Shteteve Kontraktuese.

Neni 14

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Kontraktuese lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet me mjete të tjera, i paraqiten Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e çdonjëres prej palëve në mosmarrëveshje.

Neni 15

1. Kjo Konventë zbatohet ndaj të gjitha territoreve jovetëqeverisëse, nën kujdestari, koloniale dhe të tjera territoreve jourbane, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjës një Shtet Kontraktues; Shteti Kontraktues në fjalë, në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, deklaron territorin ose territoret urbane ndaj të cilave Konventa do të zbatohet ipso facto si rezultat i këtij nënshkrimi, ratifikimi ose aderimi.

2. Në çdo rast në të cilin, për qëllim të shtetësisë, një territor jourban nuk trajtohet si i bashkuar me një territor urban, ose në çdo rast në të cilin kërkohet pëlqimi paraprak i një territori jourban nga ligjet ose praktikat kushtetuese të Shtetit Kontraktues ose të territorit jourban për zbatimin e Konventës ndaj atij territori, ai Shtet Kontraktues përpiqet të sigurojë pëlqimin e nevojshëm të territorit jourban brenda periudhës së dymbëdhjetë muajve nga data e nënshkrimit të Konventës nga ai Shtet Kontraktues dhe, kur një pëlqim i tillë është arritur, Shteti Kontraktues njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Kjo Konventë zbatohet ndaj territorit ose territoreve të përmendura në këtë njoftim nga data e marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Pas skadimit të periudhës dymbëdhjetëmuajore të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, Shtetet Kontraktuese në fjalë informojnë Sekretarin e Përgjithshëm për rezultatin e këshillimeve në ato territore jourbane, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave ato janë përgjegjës dhe që pëlqimi i tyre ndaj zbatimit të kësaj Konvente mund të jetë mbajtur i fshehur.

Neni 16

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në selinë qendrore të Kombeve të Bashkuara nga 30 gushti 1961 deri në 31 maj 1962.

2. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim në emër të:

a) çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara;

b) çdo shteti tjetër i ftuar për të ndjekur konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin ose reduktimin e pashtetësisë në të ardhmen;

c) çdo shteti, ndaj të cilit mund t'i jetë drejtuar një ftesë për të nënshkruar ose për të aderuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

4. Kjo Konventë është e hapur për aderimin nga shtetet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni. Aderimi kryhet me depozitimin e instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 17

1. Në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit çdo shtet mund t'u bëjë një rezervë neneve 11, 14 ose 15.

2. Asnjë rezervë tjetër ndaj kësaj Konvente nuk është e pranueshme.

Neni 18

1. Kjo Konventë hyn në fuqi dy vjet pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose aderon në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit, ajo hyn në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit nga një shtet i tillë i instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit ose në datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, cilado është më e vonshme.

Neni 19

1. Çdo Shtet Kontraktues mund ta denoncojë këtë Konventë, në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim të adresuar tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Një denoncim i tillë sjell pasoja për Shtetin Kontraktues në fjalë një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Në rastet ku, në përputhje me dispozitat e nenit 15, kjo Konventë është bërë e zbatueshme në një territor jorurban të një Shteti Kontraktues, ai shtet mund në çdo kohë pas kësaj, me pëlqimin e territorit në fjalë, të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara duke e denoncuar këtë Konventë në mënyrë të veçantë në lidhje me atë territor. Denoncimi sjell pasoja një vit pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili njofton të gjitha Shtetet e tjera Kontraktuese për një njoftim të tillë dhe datën ose marrjen e tij.

Neni 20

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njofton të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare, duke iu referuar nenit 16, për veçoritë e mëposhtme:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet sipas nenit 16;
- b) rezervat sipas nenit 17;
- c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në zbatim të nenit 18;
- d) denoncimet sipas nenit 19.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit ose aderimit më së voni, sjell në vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme çështjen e krijimit, në përputhje me nenin 11, të një trupi të tillë siç është përmendur aty.

Neni 21

Kjo Konventë regjistrohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në datën e hyrjes së saj në fuqi.

Në dëshmi nga ku nënshkruesit e plotfuqishëm kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në New York, më 30 gusht 1961 në një kopje të vetme, prej së cilës tekstet në gjuhën kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njëloj autentike dhe të cilat depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara dhe kopje të verifikuara të të cilave shpërndahen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare të referuara në nenin 16 të kësaj Konvente.

SHTOJCË

AKTI PËRFUNDIMTAR I KONFERENCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA MBI ZHUKJEN OSE PAKËSIMIN E PASHTETËSISË NË TË ARDHMEN

1. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me anë të Rezolutës 896 (IX) të 4 dhjetorit 1954, shprehu dëshirën e saj që të thirret një konferencë ndërkombëtare e të plotfuqishmëve për të përfunduar një konventë për pakësimin apo zhdukjen e pashtetësisë në të ardhmen, sapo të paktën njëzet shtete t'i kenë përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në një konferencë të tillë. Sekretarit të Përgjithshëm iu kërkua që të caktojë datën dhe vendin e saktë për konferencën, kur të përmbushej ky kusht. Asambleja e Përgjithshme vuri në dukje se Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare i kishte paraqitur asaj disa projekte të një Konvente mbi eliminimin e pashtetësisë në të ardhmen dhe të një Konvente mbi pakësimin e pashtetësisë në të ardhmen në raportin e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare për sesonin e saj të gjashtë në 1954.

Asambleja e Përgjithshme u kërkoi qeverive të shteteve të ftuara për të marrë pjesë në konferencë që të shqyrtonin sa më shpejt përparësitë e një konvente shumëpalëshe mbi zhdukjen ose pakësimin e pashtetësisë në të ardhmen.

2. Pas plotësimit të kushtit të përcaktuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm thirri një konferencë të Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin apo pakësimin e pashtetësisë në të ardhmen në Zyrën Europiane të Kombeve të Bashkuara në Gjenevë më 24 mars 1959. Konferenca u mbajt në Zyrën Europiane të Kombeve të Bashkuara nga data 24 mars deri më datën 18 prill 1959.

3. Në kohën e mbylljes së saj më 18 prill 1959 konferenca adaptoi rezolutën në vijim:

Konferenca,

duke pasur të pamundur të përfundojë punën që i ishte besuar brenda kohës së parashikuar për punën e saj, u propozon organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara që ta rimbledhin konferencën në kohën më të shpejtë të mundshme, me qëllim që ajo të vazhdojë dhe përfundojë punën e saj.

4. Në vijim të kësaj rezolute, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, pasi u sqarua mbi pikëpamjet e shteteve pjesëmarrëse, vendosi që konferenca duhet të rimblidhet në Selinë Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Nju York më 15 gusht 1961. Konferenca u mbajt në Qendrën e Kombeve të Bashkuara nga data 15 deri më datën 28 gusht 1961.

5. Në pjesën e parë të konferencës u përfaqësuan qeveritë e tridhjetë e pesë shteteve si vijojnë: Argjentina, Austria, Belgjika, Brazili, Kanadaja, Cejloni, Kili, Kina, Danimarka, Republika Domenikane, Republika Federale Gjermane, Franca, Selia e Shenjtë (Vatikani), India, Indonesia, Iraku, Izraeli, Italia, Japonia, Lihtenshtejni, Luksenburg, Holanda, Norvegjia, Pakistani, Panamaja, Peruja, Portugalia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Republika e Bashkuar Arabe, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, Shtetet e Bashkuara, Jugosllavia.

6. Qeveritë e shteteve në vijim u përfaqësuan nga vëzhgues: Finlanda, Greqia.

7. Në pjesën e dytë të konferencës u përfaqësuan qeveritë e tridhjetë shteteve si vijojnë: Argjentina, Austria, Belgjika, Brazili, Kanadaja, Cejloni, Kina, Danimarka, Republika Domenikane, Republika Federale Gjermane, Finlanda, Franca, Selia e Shenjtë (Vatikani), Indonesia, Izraeli, Italia, Japonia, Holanda, Norvegjia, Pakistani, Panamaja, Peruja, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Republika e Bashkuar Arabe, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, Shtetet e Bashkuara, Jugosllavia.

8. Qeveritë e shteteve në vijim u përfaqësuan nga vëzhgues: Greqia, Iraku.

9. Në pjesën e parë të konferencës u përfaqësuan nga vëzhgues organizatat ndërqeveritare si vijojnë;

Këshilli i Europës

Komiteti Ndërqeveritar për Migrimin European

Instituti Ndërkombëtar për Njëjtësimin e së Drejtës Private

Lidhja e Shteteve Arabe.

10. Në pjesën e dytë të konferencës, organizatat ndërqeveritare në vijim u përfaqësuan nga vëzhgues: Lidhja e Shteteve Arabe.

11. Në të dy pjesët e konferencës, Zyra e Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët u përfaqësua nga një vëzhgues.

12. Në pjesën e parë të konferencës Z. Knud Larsen (Danimarkë) u zgjodh si kryesues dhe Z. Ichiro Kawasaki (Japan) dhe Z. Humberto Calamari (Panama) si zëvendëskryesues.

13. Në pjesën e dytë të konferencës asnjëri nga këta zyrtarë të konferencës nuk ishin të pranishëm. Si rrjedhim konferenca zgjodhi Z. Willem Riphagen (Hollandë) si kryesues dhe Z. Gilberto Amada (Brazil) dhe Z. G.P. Malalasekera (Cejlon) si zëvendëskryesues.

14. Në pjesën e parë të konferencës u ngritën komitetet si vijojnë:

Komiteti i të Tërëve

KryetarKryesuesi i pjesës së parë të konferencës.

NënkryetarZëvendëskryesuesit e pjesës së parë të konferencës.

Komiteti i hartimit

Anëtarë: Përfaqësuesit e shteteve në vijim: Argjentinë, Belgjikë, Francë, Izrael, Panama,

Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut.

Kryetar

(në pjesën e parë të konferencës): Z. Humberto Calamari (Panama)

(në pjesën e dytë të konferencës): Z. Enrique Ros (Argjentinë).

15. Në pjesën e dytë të konferencës Komiteti i të Tërëve nuk u zgjodh.

16. Në të dy pjesët e konferencës, kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit, në përputhje me rregullën 3 të rregullave të procedurës, shqyrtuan kredencialet e përfaqësuesve dhe raportuan sa më sipër para konferencës.

17. Në pjesën e dytë të konferencës u ngrit një grup pune në përbërjen e të cilit ishin kryesuesi, që vepronte edhe si kryetar, dhe përfaqësues të Brazilit, Kanadasë, Francës, Izraelit, Norvegjisë, Zvicrës, Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, si dhe përfaqësues të shteteve të tjera që deshën të merrnin pjesë. Z. Peter Harvey (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut) veprroi si raportues i grupit të punës.

18. Në pjesën e parë të konferencës Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u përfaqësua nga Z. Yuen-li Liang, Drejtor i Sektorit të Kodifikimit të Zyrës së Çështjeve Ligjore të Kombeve të Bashkuara, i cili u caktua gjithashtu edhe si Sekretar Ekzekutiv.

19. Në pjesën e dytë të konferencës Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u përfaqësua nga Z. C.A. Stavropoulos, nga Këshilli Ligjor; Z. Yuen-li Liang veprroi si Sekretar Ekzekutiv.

20. Në pjesën e parë të konferencës u vendos që ajo të merrte për bazë për punën e saj projektkonventën mbi pakësimin e pashtetësisë në të ardhmen përgatitur nga Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare. Pjesa e parë e konferencës gjithashtu pati përpara vëzhgimet e paraqitura nga qeveritë mbi atë projektkonventë, një memorandum me një projektkonventë mbi pakësimin e pashtetësisë paraqitur nga Danimarka, si edhe një dokumentacion paraprak të përgatitur nga Sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

21. Pjesa e dytë e konferencës kishte përpara, përveç dokumentacionit të referuar më lart, dhe vëzhgimet e paraqitura nga qeveritë mbi mungesën e shtetësisë, vëzhgimet e paraqitura nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët, si edhe dokumentacionin e mëtejshëm të përgatitur nga Sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

22. Mbi bazën e mendimeve të deriatëhershme, siç qenë ato të mbajtura në regjistrat e Komitetit të të Tërëve dhe ato të takimeve plenare, konferenca përgatiti një Konventë mbi pakësimin e pashtetësisë. Konventa, e cila do t'i nënshtrohet ratifikimit, u adaptua nga konferenca më 28 gusht 1961 dhe u hap për nënshkrim që nga 30 gushti 1961 e deri më 30 maj 1962 në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Kjo Konventë u hap gjithashtu për aderim dhe do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

23. Për më tepër konferenca adaptoi katër rezoluta që i janë bashkëngjitur këtij akti përfundimtar.

Përfaqësuesit nënshkruan këtë akt përfundimtar.

Përfunduar në Nju Jork më 30 gusht 1961 në një kopje të vetme nga të cilat tekstet në gjuhën kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle janë njëlloj origjinale dhe të cilat do të depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara dhe kopje të vërtetuara të të cilave do t'u shpërndahen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të gjithë anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, si edhe të gjitha shteteve joanëtare të ftuara në konferencë.

L I G J

Nr.9060, datë 8.5.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3827, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA
PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE
TË HUAJA (5 TETOR 1961)

Shtetet Palë në këtë Konventë,
me dëshirën për të hequr kërkesën për legalizim diplomatik dhe konsullor të dokumenteve
zyrtare të huaja,
vendosën të hartojnë këtë Konventë duke rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë
dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë.

Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare:

- a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit,
përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretariatë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore;
- b) dokumentet administrative;
- c) aktet noteriale;
- d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij
si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si
edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë së firmave.

Kjo Konventë nuk zbatohet:

- a) për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë;
- b) për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore.

Neni 2

Çdo Shtet Palë përjashton nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat
zbatohet kjo Konventë. Në kuptim të kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm aktin e formalitetit,
me anë të të cilit agjentët diplomatikë ose konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet
dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e firmës, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur
dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që bart.

Neni 3

Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që
firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që

mund të kërkohet është paraqitja e një certifikate, të përshkruar në nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin.

Megjithatë, formaliteti i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk mund të kërkohet në rastin kur ligjet, rregulloret dhe praktika në fuqi në shtetin në të cilin lëshohet dokumenti ose një marrëveshje midis dy a më shumë Shteteve Palë e shmang, e thjeshton ose e përjashton dokumentin nga legalizimi.

Neni 4

Certifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për së gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente.

Megjithëse ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, certifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge “Apostille” (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961).

Neni 5

Certifikata lëshohet me kërkesë të personit që ka firmosur dokumentin ose të çdo personi tjetër. Nëse plotësohet saktësisht, ajo vërteton autenticitetin e firmës, cilësinë në të cilën ka vepruar personi që e ka firmosur dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës ose pullës që ky dokument bart.

Firma, vula dhe pulla në certifikatë përjashtohen nga çdo lloj vërtetimi i mëtejshëm.

Neni 6

Mbështetur në paragrafin e parë të nenit 3, çdo Shtet Palë përcakton autoritetin kompetent për nxjerrjen e certifikatës në përputhje me funksionin zyrtar të tij.

Në momentin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të aderimit ose të deklaratës së zgjerimit, Shteti Palë njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës për caktimin e autoritetit kompetent për nxjerrjen e certifikatës, si edhe për ndryshimet e mundshme të autoritetit kompetent në të ardhmen.

Neni 7

Autoriteti kompetent, në zbatim të nenit 6, mban një regjistër në të cilin regjistrohen certifikatat e lëshuara, duke specifikuar:

- a) numrin dhe datën e certifikatës;
- b) emrin e personit që firmos dokumentin zyrtar dhe cilësinë në të cilën ka vepruar ose, në rastet e dokumenteve të pafirmosura, emrin e autoritetit që ka vënë vulën ose pullën.

Me kërkesë të personit të interesuar, autoriteti që ka lëshuar certifikatën vërteton nëse të dhënat në certifikatë korrespondojnë me të dhënat e mbajtura në regjistër.

Neni 8

Nëse midis dy ose më shumë Shteteve Palë ekziston një marrëveshje, traktat ose konventë, që përmban dispozita që lidhen me vërtetimin e firmës, vulës ose pullës për disa formalitete të caktuara, dispozitat e kësaj Konvente kanë përparësi përsa u takon atyre dispozitave që sanksionojnë formalitete më strikte, sesa ato të parashikuara në nenet 3 dhe 4.

Neni 9

Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të shmangur legalizimin e dokumenteve nga agjentët e tij diplomatikë dhe konsullorë në rastet kur kjo Konventë parashikon përjashtimin.

Neni 10

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private si dhe për Islandën, Irlandën, Lichtenstein dhe Turqinë.

Pas ratifikimit instrumentet përkatës depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Neni 11

Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 10.

Konventa hyn në fuqi për çdo Shtet Palë që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumenteve përkatëse të ratifikimit.

Neni 12

Çdo shtet, që nuk përmendet në nenin 10, mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës.

Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe Shteteve Palë, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e lajmërimit, parashikuar nga neni 15 pika d. Për çdo kundërshtim duhet të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Konventa hyn në fuqi, ndërmjet shtetit aderues dhe shteteve, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtime për këtë aderim ditën e gjashtëdhjetë pas përfundimit të periudhës 6 - mujore, përmendur në paragrafin më sipër.

Neni 13

Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit dhe aderimit, çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.

Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili e ka nënshkruar dhe e ka ratifikuar Konventën, kjo Konventë hyn në fuqi për territoret në fjalë në përputhje me dispozitat e nenit 11. Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili ka aderuar, kjo Konventë hyn në fuqi për këto territore në përputhje me dispozitat e nenit 12.

Neni 14

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 1 paragrafi i parë, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar ose e kanë aderuar në një datë të mëvonshme.

Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet. Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh.

Ajo mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë.

Neni 15

Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës u njofton Shteteve Palë të përmendura në nenin 10, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 12, sa më poshtë:

- a) njoftimin e parashikuar në nenin 6 paragrafi i dytë;
- b) nënshkrimet dhe ratifikimet e parashikuara në nenin 10;
- c) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë;
- d) aderimet dhe kundërshtimet e parashikuara në nenin 12 dhe datën në të cilën ato bëhen efektive;
- e) zgjerimet e parashikuara në nenin 13 dhe datën në të cilat ato bëhen efektive;
- f) denoncimet e parashikuara në nenin 14 paragrafi i tretë.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë në Hagë, më 5 tetor 1961 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të lidhura në një kopje të vetme, ku teksti frëngjisht ka përparësi në rast divergjencash ndërmjet dy teksteve. Kopja e vetme depozitohet në arkivat e Qeverisë hollandeze. Prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e nëntë të konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Islandës, Irlandës, Lichtenstein dhe Turqisë.

SHTOJCË E KONVENTËS

Model i certifikatës

Certifikata do të jetë në formën e një katrori me brinjë jo më të vogla se 9 cm.

Apostille

Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961

1.vendi.....

Ky dokument zyrtar

2.është firmosur nga.....

3.i cili vepron në cilësinë e.....

4.dhe mban vulën/pullën e.....

Vërtetohet

5.në.....6. me.....

7.nga.....

8.nr.....

9.vula/pulla.....10.firma.....

L I G J

Nr.9061, datë 8.5.2003

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8500, DATË 10.6.2000

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8500, datë

10.6.2000, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 pika 9 bëhen këto ndryshime:

- në shkronjën “a” shtohen fjalët: “Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror”;
- në shkronjën “a”, pas fjalëve “këshillave të rretheve” shtohen fjalët “këshillave të qarqeve”;
- në shkronjat “a” dhe “b”, pas fjalëve “institucione qendrore” shtohet fjala “buxhetore”;
- në shkronjat “c” dhe “d”, kudo ku janë përmendur fjalët “funksion dhe pagë”, hiqet fjala “pagë”.

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

- a) 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;
- b) 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji;
- c) 2 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

- Tre paragrafët e parë riformulohen si më poshtë:

“Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.”.

- Paragrafi i parafundit riformulohet si më poshtë:

“Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Personat, të cilët nuk plotësojnë periudhën e shërbimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në raport me periudhën e shërbimit në funksion apo në detyrë.”.

- Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

Pas shkronjës "b" të paragrafit të parë të shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) për personat e pikës 3 të nenit 8 të këtij ligji, 1 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbim në funksionet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 8 të nenit 1 dhe 0,8 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbimi në funksionet apo detyrat e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 8 të nenit 1."

Neni 6

Në nenin 10 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) pas arritjes së moshës për pension të plotë pleqërie ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë."

Neni 7

Në nenin 13, në paragrafin e parë, fjalët "e nenit 11" zëvendësohen me fjalët "e nenit 12".

Neni 8

Në nenin 15, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia:

"Periudhë shërbimi, për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha, gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar."

Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

"Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë", nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3828, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J **Nr.9063, 8.5.2003**

PËR STATUSIN E TRASHËGIMTARËVE TË ISH-FAMILJES MBRETËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në këtë ligj, me ish-Familje Mbretërore kuptohet familja e trashëgimtarëve të ish-Mbretit Zog I dhe ish-Mbretëreshës Geraldinë, duke përfshirë edhe pasardhësit e tyre.

Neni 2

Trashëgimtarët e ish-Familjes Mbretërore kanë të drejtë të disponojnë dhe të përdorin pronat e tyre, sipas ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si dhe të ligjeve të tjera në fuqi.

Neni 3

Trashëgimtarët e familjes së ish-Mbretit Zog I kanë të drejtë të mbajnë koleksione të ndryshme, të konsideruara pronë private, pasi ato të jenë regjistruar më parë në organet shtetërore përkatëse, në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.

Neni 4

Statusi dhe trajtimi protokollar i trashëgimtarëve të ish-Familjes Mbretërore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 1, 3 dhe 4 të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3829, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J **Nr.9064, datë 8.5.2003**

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8039, DATË 23.11.1995, NR.8074, DATË 22.2.1996, NR.8112, DATË 23.3.1996 DHE NR.8767, DATË 5.4.2001

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996, nr.8112, datë 23.3.1996 dhe nr.8767, datë 5.4.2001, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizime”, pas termit “shërbime” shtohet termi:

“Shërbimet këshillimore” janë shërbimet e këshillimit me natyrë intelektuale”.

Neni 2

Në nenin 8 “Agjencia e Prokurimit Publik” bëhen këto ndryshime:

- Pika (1) ndryshohet si më poshtë:

" (1) Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit."

- Shkronja "gj" e pikës (2) ndryshohet si më poshtë:

(gj) Përgatit dhe shpall Regjistrin Qendror të Parashikimeve të Prokurimeve dhe Regjistrin Qendror të Realizimit të Prokurimeve. "

- Në pikën (3) pas fjalës "emërohet" shtohet fjala " lirohet".

- Në pikat (3) dhe (4) emërtimi "Kryetari i Këshillit të Ministrave " ndryshohet dhe bëhet "Kryeministri".

- Pas pikës (3) shtohet pika (3/1) me këtë përmbajtje:

"(3/1) Për nëpunësit, drejtues dhe specialistë, të Agjencisë së Prokurimit Publik zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin "Statusi i nëpunësit civil", ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës."

Neni 3

Pika (3) e nenit 10 “Procesverbalet e prokurimit” ndryshohet si më poshtë:

"(3) Enti prokurues ruan dhe administron regjistrin, dokumentet e tenderit dhe çdo dokument që lidhet me prokurimet, sipas mënyrës dhe për kohën që parashikohet në ligjin për arkivat dhe në ligjin për informimin publik."

Neni 4

Në shkronjën "a" të nenit 18 "Kushtet për përdorimin e "Tenderit të kufizuar"", fjala "furnizuesish" zëvendësohet me fjalën “subjektsh”.

Neni 5

Në nenin 19 “Kushtet për përdorimin e “Prokurimit të drejtpërdrejtë”” në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën (c) në vijim të fjalëve “të cilat nuk përfshihen në kontratën fillestare” shtohen fjalët “dhe kur vlera e tyre nuk është më e madhe se 30 për qind e vlerës së kontratës fillestare”.

- Shkronja (ç) shfuqizohet.

- Shkronja (f) ndryshohet si më poshtë:

“Kur enti prokurues ka nevojë urgjente për mallra, ndërtime e shërbime, si dhe për çështje të sigurisë kombëtare dhe kur kjo nevojë urgjente është shkaktuar jashtë kontrollit të entit prokurues, enti prokurues mund të përdorë prokurimin e drejtpërdrejtë, pasi të jetë marrë më parë miratimi nga Agjencia e Prokurimit Publik.”.

Neni 6

Në nenin 30 “Paraqitja dhe pranimi i ofertave” bëhen këto ndryshime:

- Në fjalinë e dytë të pikës (1), në fund të fjalisë fjalët “të mbyllura në dy zarfe të veçanta” shfuqizohen.

- Në fjalinë e katërt të pikës (1) fjalët “Në këto raste” zëvendësohen me fjalët “Në të gjitha rastet”.

- Pas pikës (2) shtohet pika (3) me këtë përmbajtje:

“(3) Ofertuesi, që ka dorëzuar ofertën para afatit të fundit të dorëzimit, ka të drejtë ta zëvendësojë ose ta tërheqë atë, me përjashtim të ditës së fundit të hapjes së tenderit.”.

Neni 7

Në nenin 31 “Hapja e ofertave” bëhen këto ndryshime:

- Pika (3) ndryshohet si më poshtë:

“(3) Emri i ofertuesit dhe vlefëta totale e çdo oferte duhet të lexohen me zë të lartë dhe të regjistrohen në procesverbal dhe, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi duhet t’i vihet në dispozicion një kopje e këtij procesverbali.”.

- Pika (4) shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 32 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” shkronja (b) e pikës (7) ndryshohet si më poshtë:

“(b) Vlera ekonomike më e mirë vlerësohet në bazë të kriterëve të specifikuar në dokumentet e tenderit, kriterë të cilat duhet të jenë objektive dhe të shprehura qartë nga ana sasiore dhe, për qëllim të vlerësimit të tenderit, duhet të shprehen në terma monetarë.”.

Neni 9

Në nenin 35 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës” bëhet ndryshimi si më poshtë:

- Në fund të pikës (3) pas fjalës “palëve” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Nëse ofertuesi fitues, brenda afatit kohor të përcaktuar në dokumentet e tenderit, nuk nënshkruan formularin e kontratës ose nuk bën sigurimin e kontratës, enti prokurues bën konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe nëse diferenca ndërmjet ofertës së klasifikuar në vendin e parë dhe të dytë do të jetë jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, atëherë do të shpallet si fitues pjesëmarrësi i renditur i dyti në klasifikim.”.

Neni 10

Në nenin 36 “Procedura e “Tenderit të kufizuar”” në shkronjën (a), në rreshtin e parë fjalët “një numri të kufizuar kandidatësh të kualifikuar” zëvendësohen me fjalët “të gjithë kandidatëve të specializuar, të njohur nga enti prokurues”.

- Në vazhdim shkronjës (a) shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Janë të lirë të marrin pjesë në këtë procedurë edhe kandidatë të tjerë, që kanë marrë dijeni për tenderin.”.

Neni 11

Në nenin 43 “Të përgjithshme”, pas pikës (1) shtohet pika (1/1) me këtë përmbajtje:

“(1/1) Paraqitja e ankesës tek titullari i entit prokurues ose tek Agjencia e Prokurimit Publik pezullon shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës deri në kthimin e përgjigjes sipas kompetencave dhe afateve të parashikuara në nenet 44 dhe 45 të këtij ligji.”.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3831, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**L I G J
Nr.9065, datë 8.5.2003**

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8487, DATË 13.5.1999 “PËR

**KOMPETENCAT PËR ÇAKTIMIN E PAGAVE TË PUNËS”, NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8935, DATË 12.9.2002**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës ", ndryshuar me ligjin nr.8935, datë 12.9.2002, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, miraton:

- a) pagën minimale mujore, në shkallë vendi, e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj;
- b) masën e indeksimit të pagave, sipas ndryshimit të pritshëm të indeksit të çmimeve të konsumit, në fillim të çdo viti dhe rregullat për zbatimin e saj."

Neni 2

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 5/1

Departamenti i Administratës Publike, në bashkërendim me Ministrinë e Financave, përgatit dhe Këshilli i Ministrave miraton:

- a) pagat e drejtuesve të institucioneve qendrore, që nuk përfshihen në nenin 4 dhe pagat e personave të tjerë të barazuar me ta, sipas nenit 4;
- b) aktet nënligjore për funksionimin e strukturës së pagave dhe të shpërblimit për punonjësit e administratës publike;
- c) strukturën e pagave për punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;
- ç) numrin e klasave, masën e pagës dhe të shtesave mbi pagë, sipas klasave, për punonjësit e administratës publike;
- d) kriteret për masën e shpërblimeve shtesë, për punën jashtë orarit zyrtar, për punonjësit e administratës publike;
- dh) përgjegjësinë e organeve të larta shtetërore, ministrive e institucioneve të tjera qendrore në fushën e pagave."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3830, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

V E N D I M
Nr.75, datë 24.4.2003

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR 2002 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
RADIOS DHE TELEVISIONIT (KKRT)**

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8655, datë 31.7.2000, nr.8794, datë 10.5.2001 dhe nr.9016, datë 20.2.2003 dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet raporti vjetor 2002 për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

U R D H Ë R
Nr.17/1, datë 21.5.2003

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP SHËNGJIN)**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”

V E N D O S A:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Shëngjin, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
Agron Duka

U R D H Ë R
Nr.17/2, datë 21.5.2003

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT
(OMP LIQENI I SHKODRËS)**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 31/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”

V E N D O S A:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Liqeni i Shkodrës, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 19.6.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë